



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Procesverbal

nga takimi publik me qytetarë i mbajtur më 26 dhjetor 2025

Takimi filloi në orën 10.25

Takimin publik e hapi dhe e kryesoi z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës.

Në takim ishin të pranishëm një numër i qytetarëve (40 pjesëmarrës);

Nënkryetari i Komunës, Drejtorët e Drejtorive të Administratës së Komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësues të OJQ-ve dhe mediat.

Tema:

Realizimi i projekteve dhe aktiviteteve tjera të parapara për vitin 2025

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, të nderuar qytetarë të Komunës së Podujevës, i respektuari Nënkryetar i Komunës dhe Drejtorë të Drejtorive ju përshëndes të gjithëve, faleminderit që keni ndarë kohën e çmuar tuajën sot që të jemi në këtë takim të përbashkët e ndërlidhet me Raportin e Kryetarit të Komunës për punët dhe projektet të cilat janë realizuar ose që janë në projekt të realizimit. Ky raportim bëhet konformë rregullativës ligjore dhe obligimeve të cilat dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale. Do të bëjë përpjekje që në pika të shkurtra të jap informacione rreth ecurisë së punëve dhe projekteve të cilat janë realizuar në vitin 2025 duke u ndalur në secilën drejtori dhe në fund sigurisht se do të kemi mundësinë që të bashkëbisedojmë eventualisht për kërkesat, nevojat apo për sfidat nëpër të cilat kemi kaluar gjatë kësaj periudhe kohore. Atëherë të fillojmë sipas Drejtorive;

DREJTORIA E ADMINISTRATËS

Si Drejtori ka vazhduar punët dhe detyrat e saja konformë rregullativës ligjore dhe çdo ditë e më shumë është duke u punuar në zgjerimin e procesit të digjitalizimit të shumë shërbimeve në mënyrë që këto shërbime të jenë sa më efikase për qytetarët tanë. Administrata çdo ditë është duke u digjitalizuar më shumë dhe janë duke u ofruar shërbime më efikase për qytetarët.

Në Sektorin e Gjendjes Civile në Podujevë, në zyrat e Gjendjes Civile në fshatra dhe në E-Kioska sipas kërkesave të qytetarëve janë lëshuar gjithsej 79 mijë e 447 certifikata të ndryshme të gjendjes civile, që është një numër jashtëzakonisht i madh, në të cilin numër hyjnë edhe një numër i madh i shërbimeve që janë kryer edhe për qytetarët të cilët janë jashtë komunës së Podujevës, në veçanti kjo lidhet me shërbimet në E-kioskun që ndodhet në vijën kufitare Kosovë -Serbi por edhe në E-Kioskun i cili ndodhet në lokalitetin e qytetit të Podujevës.

Zyra e Teknologjisë Informative ka bërë mirëmbajtjen e pajisjeve të IT-së, me të gjitha nevojat dhe kërkesat që janë paraqitur

Arkivi i Administratës komunale ka arkivuar 2500 lëndë

Është bërë servizimi dhe mbirëmbajtja e automjeteve zyrtare, etj.

DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCE

Është planifikuar dhe aprovuar buxheti për vitin 2026, buxheti më i larti në historinë e Komunës së Podujevës në vlerë prej 34,778,954.00 euro, ose për 1,319,839.00 euro më i lartë se buxheti i vitit 2025. Kjo rritje është në radhë të parë falë një pune të jashtëzakonshme që është bërë në veçanti nga zyra për tatime, zyrat të cilat grumbullojnë mjete financiare dhe të cilat e rritin shumë e mjeteve financiare për nevoja të Komunës tonë.

Të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës të realizuara në vitin 2025 janë afër 2.7 milionë euro, pra kemi një tejkalim të të hyrave vetanake në shumë prej 700 mijë euro.

Këto mjete do të alokohen në vitin 2026, dhe do shërbejnë për realizimin e projekteve kapitale në interes të zhvillimit ekonomik - shoqëror të Komunës së Podujevës.

Gjatë vitit 2025 janë regjistruar 1 mijë e 200 objekte në sistemin e tatimit në pronë, që do të ndikojë pozitivisht në rritjen e të hyrave vetanake në vitin 2026.

Buxheti i vitit 2025 është shpenzuar mbi 99% e mjeteve nga granti i përgjithshëm, që tregon për një realizim të mirë të buxhetit, i cili ka qenë në vlerë të përgjithshme prej 33,459,115.00 euro. Asnjëherë në historikun e Komunës së Podujevës nuk kemi pas shpenzim në këtë përqindje të lartë të buxhetit komunal. Gjithherë ka pas mjete buxhetore që kanë mbetur në suficit. Madje këtu duhet theksuar se në sajë të Kontratës Kolektive një numër i madh i punëtorëve të arsimit ka arritur të realizojë të drejtën e cila u ka takuar konformë kontratës së cekur dhe si rrjedhojë kemi disa projekte në të cilat faktikisht jemi në borxhe dhe këto pagesa duhet ti bëjmë në fillim të vitit të ardhshëm për shkak se diku afërsisht ky vit buxhetor është mbyllur me rreh katër(4) milion euro mjete të cilat janë shpenzuar për Kontratën Kolektive.

DREJTORIA E ARSIMIT

Në vazhden e punëve të saj ka realizuar një numër të madh të projekteve të rëndësishme gjatë vitit 2025.

Është realizuar projekti “Furnizim me kabinete shkollore”; vlera e projektit është 145 mijë e 599 €.

Është realizuar projekti “Furnizim me inventar për çerdhe”; vlera e projektit është 112 mijë e 861 €.

Është realizuar projekti “Furnizim me kabinete për shkollën “Fan S. Noli” në Podujevë”, në bashkëfinancim me IOM-in; vlera financiare është 12 mijë e 964 €.

Është realizuar projekti “Furnizim me kabinete të shkencave” në SHFMU “Shefki Kuleta” në paralelen e ndarë fizike; vlera financiare është 21 mijë e 940 €, si dhe një pjesë financuar nga KFOR-i Turk.

Është realizuar projekti “Furnizim me drunj frutorë për hapësirat publike”; vlera financiare është 6 mijë 275 €.

Është në përfundim e sipër “Projekti me masa efçiente në 4 shkolla”; vlera e projektit është 698 mijë e 728.80 €.

Është duke u realizuar projekti “Ndërtimi i SHFMU “Nuhi Gashi” në Bradash”; vlera e projektit është 624 mijë e 249.74 €.

Është duke u realizuar projekti “Ndërtimi i sallës së sporteve në SHFMU “Shaban Shala” në Podujevë”, në bashkëfinancim me MASHTI-n; vlera e projektit është 378 mijë e 970.95 €.

Është duke u realizuar projekti “Ndërtimi i sallës së sporteve në SHFMU “Kongresi i Manastirit” në Gllamnik, në bashkëfinancim me MZHR-në; vlera e projektit është 384 mijë e 996.79 €.

Është duke u realizuar projekti “Ndërtimi i kuzhinës qendrore”, për nevoja të shujtave për nxënësit tanë, vlera e projektit është 698 mijë e 32.60 €.

Është duke u realizuar projekti “Ndërtimi i aneksit të SHFMU “Naum Veqilharxhi” në Llapashticë të Epërme” – vlera e projektit është 77 mijë e 222 €.

Është duke u realizuar projekti “Furnizimi me material shkolle”; vlera e financiare është 24 mijë e 969.50 €.

Është duke u realizuar projekti “Furnizim dhe mirëmbajtje të kamerave në shkolla”; vlera financiare është 10 mijë €.

Është duke u realizuar projekti “Ndërtimi i aneksit të SHFMU “Dr. Ibrahim Rugova” në Podujevë”; vlera e projektit është 648 mijë e 841.84 €.

Është duke u realizuar projekti “Ndërtimi i aneksit të SHFMU “Enver Maloku” në Podujevë”; vlera e projektit është 562 mijë e 222 €.

Është duke u realizuar projekti “Transporti i nxënësve në shkolla” (për nxënësit që kanë distancë shtëpi–shkollë minimumi 4 km); vlera e financiare është 142 mijë e 159.55 €.

Ka filluar “Ndërtimi i SHFMU “Jetullah Gashi” në Dobërdol”; vlera e projektit është 664 mijë e 995.24 €.

Ndërsa përmes ndërmarrjes Eko-Llapi është intervenuar në 27 objekte shkollore dhe në 10 shkolla është ende duke u punuar në meremetime të ndryshme.

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Janë subvencionuar 991 qytetarë me sëmundje kronike në mbulimin e shpenzimeve për barna në vlerë 172 mijë e 950€.

Janë subvencionuar me 20 mijë euro OJQ-të si Handikos, Autizmi dhe OFAP, të cilat merren me trajtimin e personave me nevoja të veçanta.

Projektet e planifikuara dhe të realizuara për vitin 2025

Në bashkëpunim me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit” është në fazën finale së ndërtuari Qendra Rezidenciale për të moshuar në vlerë 2.5 milionë euro dhe tani është në fazën e inventarizimit, dhe shpresojmë se shumë shpejtë kjo kategori do ta kenë këtë objekt në dispozicion të tyre.

Është bërë furnizimi me Rentgen për shërbimin e radiologjisë në vlerë 53,886.60 euro.

Rinovimi i hapësirave për infuzione në QKMF në vlerë 14 mijë e 444 euro.

Furnizimi me bombola të oksigjenit 50 litër 20 copë.

Furnizim me EKG për nevojat e shërbimeve në qendër dhe terren.

Inventarizimi dhe pajisja e dhomës për Edukim dhe Promovim Shëndetësor në Maternitet – investim nga UNICEF, AQH dhe Ministria e Shëndetësisë.

Furnizim me 35 kompjuterë të rinj për nevoja të Sistemit Informativ Shëndetësor nga Ministria e Shëndetësisë.

Projekte në realizim

Furnizim me barna dhe material stomatologjik, Furnizim me reagensë dhe material laboratorik dhe

Furnizim me filma rëntgeni 443,706.00 euro

Furnizim me Oksigjen 6,750.00 euro

Servisim të pajisjeve radiologjike, stomatologjike dhe laboratorike 35,000.00 euro

Furnizim me Dokumentacion Mjekësor 55,000.00 euro, etj.

Në bashkëpunim me OJQ-të humanitare janë ndihmuar 1632 familje me pako ushqimore dhe 5000 kg miell si dhe 50 persona janë duke u ndihmuar me shujtë ditore në bashkëpunim me donatorë.

Statistika të vizitave dhe shërbimeve

Numri i vizitave në QKMF 169 mijë 405.

Numri i vizitave në terren (QMF dhe AMF) 40 mijë e 745.

Numri i vizitave në Emergjencë 35 mijë e 993.

Numri i shërbimeve në QKMF, QMF dhe AMF është 348 mijë e 240.

Strehimi: Gjatë vitit 2025 Komuna e Podujevës ka nënshkruar marrëveshje me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit” për ndërtimin e 5 shtëpive për familjet në nevojë. 3 shtëpi janë ndërtuar dhe 2 të tjera pritet të ndërtohen. Po ashtu nga donatorë të ndryshëm janë ndërtuar edhe 7 shtëpi të tjera nga lista e pritjes.

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Infrastruktura

Gjatë vitit 2025 ka përfunduar asfaltimi i rrugëve në fshatrat Shajkoc, Sfeçël, Surkish, Dumosh, Herticë, Batllavë, Lladovc, Dyz dhe Orllani me rrethinë.

Në realizim e sipër është asfaltimi i rrugëve në fshatrat Gllamnik, Siboc, Lupç i Poshtëm, Sallabajë, Halabak, Bellopojë, Gërdoc, Tërnavë, Metehi, Revuqë, Zakut, Kërpimëh, Pakashticë, Dobratin, Buricë, Majac, Popovë, Konushec, Lluga, Godishnjak, Pollatë, Dvorishtë, Zhiti dhe Tërnavicë. Ndërsa në proces është asfaltimi i rrugëve në Livadicë, Miroc, Llapashticë-Popovë, Dumnicë dhe Llaushë.

Pos këtyre rrugëve, kemi edhe disa **projekte trevjeçare (2025, 2026,2027)** që janë bashkëfinancim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës :

Këto janë: ndërtimi i rrugëve në fshatin Sylevicë dhe Tërnavicë, Ndërtimi i rrugës Orllan-Rakinicë dhe rrugës Rubiku në Orllan si dhe ndërtimi i trotuarit te ura në Orllan.

Rikonstruimi dhe asfaltimi i rrugëve në qytet: Bahri Fazliu, Agron Rrahmani, Ali Ajeti, 19 Qershori, Bedri Bajrami, si dhe ndërtimi i urës mbi lumin Llap rruga lidhëse me rrugën nacionale.

Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Përpellac, Dobërdol, Pakashticë, Metehi, Dumnicë, Bellopojë, Brainë, Tërnavë, Llapashticë, Gllamnik, Sfeçël, Dumosh, dhe rrethinë-Podujevë –pjesa e parë, Bajçinë, Dobërdol, Pakashticë, Metehi, Dumnicë, Bellopojë, Brainë, Tërnavë, Llapashticë, Gllamnik, Sfeçël, Dumosh dhe rrethinë-Podujevë - pjesa e dytë,

Riasfaltimi dhe rikonstruimi me infrastrukturë përcjellëse i rrugës Podujevë-Letanc, riasfaltimi dhe rikonstruimi me infrastrukturë përcjellëse i rrugës 28 Nëntori.

Kur t'i kthejmë këto rrugë në kilometra janë afro 50 kilometra asfalt që kapin vlerë mbi 9 milionë euro. Nëse ndokujt i intereson në mënyrë më të detajuar çështja e këtyre rrugëve unë kam përgatitur edhe një tabelë të cilën mund të ua jam dhe të shihni këto projekte në mënyrë më të detajuar.

Drejtoria e Urbanizmit ka realizuar edhe punë tjera. Gjatë vitit 2025 i ka pasur 11 kërkesa mjedisore prej të cilave 7 janë aprovuar dhe 1 është në proces.

Pastaj 68 kërkesa për informatë për Planin Urbanistik prej të cilave 58 janë aprovuar dhe 8 janë në proces të shqyrtimit,

41 kërkesa për kushte ndërtimore prej të cilave 14 janë aprovuar dhe 13 janë në proces të shqyrtimit,

24 kërkesa për leje ndërtimore, prej të cilave 14 janë aprovuar dhe 8 janë në proces.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe njëvjeçare kanë qenë 23 kërkesa për legalizim, ku janë lëshuar 9 certifikata për legalizim, 8 janë në proces, 4 në listë të pritjes dhe 2 janë refuzuar.

Kërkesa të ndryshme kadastrale të pranuar në punë gjatë kësaj periudhe janë 10 mijë e 503.

Prej tyre 10 mijë e 160 kërkesa janë aprovuar, 231 janë anuluar dhe 112 janë ende në procedurë.

Shkalla e aprovimit 96.7 për qind.

Për regjistrimin e bartjes së pronësisë kanë qenë 2,115 kërkesa

Kërkesa për ndarje, bashkim, përcaktim, legalizim, ndërrim kulture dhe ri-rregullim të njësive kadastrale 625

54 kërkesa për historik pronësie nga persona fizikë dhe juridikë.

DREJTORIA E PRONËS KADASTËRIT DHE GJEODEZISË

152 kërkesa për regjistrimin e hipotekave dhe çregjistrimin e hipotekës janë shqyrtuar dhe të gjitha janë aprovuar.

548 kërkesa për korigjimin e të dhënave personale në certifikatën e pronësisë janë përpunuar.

27 kërkesa për shënimin e urdhërit përmbartimor, kërkesa për shënimin e Masës së Përkohshme të Sigurisë nga gjykata, kërkesë për lirim të barrës tatimore, Shënimi i barrës tatimore mbi njësi kadastrale etj.

6 mijë e 310 kërkesa për certifikata pronësie, kopje të planit, koordinata për njësi, vërtetim që pala nuk posedon paluajtshmëri.

DREJTORIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT

Sa i përket investimeve kapitale, ka përfunduar ndërtimi i aneksit dhe është bërë rinovimi i hapësirave të Teatrit “Avdush Hasani”.

Ka përfunduar ndërtimi i Memorialit dhe shtatorja e heroit Afrim Zhitia në fshatin Lluga.

Ka përfunduar ndërtimi i terreneve sportive, vendosja e rrethojave, barit sintetik ose ndriçimit në vlerë 425,000 euro, projekt dyvjeçar, në këto lokacione:

Peran, lagjen e Polonicëve, Gllamnik, Lupç, Siboc, Sfeçël, Surkish, lagjen e Brecalive, fushën e sportit mbrapa postës në qytet, Pollatë, Bellopojë, Gërdoc, Sekiraçë, Kaqybeg, Dumnicë e Poshtme, Obrançë, fusha e tenisit dhe fushës së voljebollit në rërë në Parkun e Mançesterit, dhe punimi i hapësirave në dy etazhe në objektin e palestrës për sportet marciale.

Është duke vazhduar ndërtimi i Qendrës Multifunksionale dhe pritet të funksionalizohet në fillim të vitit 2026.

Është duke vazhduar ndërtimi i Pishinës Gjysëmolimpike

Ka filluar edhe ndërtimi i fushës së dytë të tenisit në Parkun Mançester.

Subvencione

Bazuar në thirrjet publike për financim të OJQ-ve në Kulturë, Rini dhe Sport, në vitin 2025 janë subvencionuar klubet, shoqatat sportive, OJQ-të kulturore dhe rinore me përafërsisht 120,000 euro.

Kultura

Në Galerinë e Arteve janë mbajtur 10 ekspozita. Po ashtu janë mbajtur edhe 10 manifestime të ndryshme kulturore dhe përkujtimore.

Në “Ditët e Diasporës”, përveç aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe sportive, janë mbajtur edhe 11 koncerte dhe 4 panai, 1 panair i librit dhe 3 me produkte artizanale.

Teatri

Gjatë këtij viti janë dhënë dy premjera dhe 26 repriza të shfaqjeve për të rritur dhe për fëmijë.

Trupa e Teatrit “Avdush Hasani” gjatë vitit 2025 ka marrë pjesë në festivale teatrore brenda dhe jashtë vendit.

Sporti

Janë mbajtur 43 organizime sportive, si turne në futboll, gara në basketboll, volejbol, atletikë, triathlon, Festivali i Kajakimit, tenis, ping pong, shah, not, çiklizëm, bjeshkatari, arte marciale, karate, xhudo, kik boks.

Po ashtu ka pasur edhe aktivitete tjera me theks të veçantë përfshirjen e vajzave në sport, janë përkrahur aktivitetet e organizuara për komunitetin ashkali në kulturë dhe sport dhe janë subvencionuar projektet sportive dhe edukative për personat e verbër.

Biblioteka

Biblioteka e Qytetit këtë vit është pasuruar me 536 tituj të rinj me gjithsej 2894 ekzemplarë.

Po ashtu janë mbajtur edhe aktivitete tjera për librin.

Gjatë këtij viti janë kryer punë e aktivitete edhe në Arkivin e Komunës.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE MBROJTJES DHE SHPËTIMIT

Janë ndërtuar 3 mijë e 700 metra trotuar.

Është duke u hartuar projekti për rregullimin e shtratit të lumit në qytet.

Janë ndërtuar 35.6km ndriçim publik.

Ka filluar rregullimi i varrezave në qytet.

Ka filluar ndërtimi i kolektorit nga fshati Lluzhan, Lupç dhe Gërdoc-Lluzhan. Deri tash janë punuar 5 mijë e 541m.

Ka filluar rregullimi i rrugëve me zhavorr: disa janë shtruar dhe të tjerat janë në proces në kuadër të kësaj kontrate.

Furnizimi dhe montimi i gypave: Brainë, Pakashticë, Dobërdol, Gllamnik, Surkish, Dyz-Halabak, Revuqë, Brecë, etj.

Ndërtimi i mureve mbrojtëse në gjatësi prej 176m.

Janë ndërtuar 4 ura dhe 2 janë në proces të ndërtimit.

Është bërë mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve sipas kërkesave.

Mirëmbajtja e infrastrukturës: Janë pastruar 85 puseta, është intervenuar në 2310 metra, deblllokim, ndërrim i gypave 154m, 35 kapakë të pusetave, 3 puseta të ndërtuara.

Mirëmbajtja e lumenjve: Janë relizuar 850 m pastrim dhe rregullim në Lumin “Dumnica”.

Është bërë mirëmbajtja dhe furnizimi me kamera.

Është bërë mirëmbajtja e sistemit të ujitjes

Janë mbjell 1800 drunj dekorativë në qytet dhe fshatra..

Janë trajtuar 291 qen endacakë.

Janë mbjellë 13000 lule të llojeve të ndryshme.

Janë ndërruar 2 mijë e 210 trupa ndriçues të dëmtuar, është bërë intervenimi në kutinë shpërndarëse 69 raste, është bërë montimi i 1860m kabëll.

Janë zëvendësuar 540m² kubëza, janë ndërruar 220 m skajore dhe 92m parmak të urave.

Është dekoruar qyteti për festat e fundvitit.

Janë pajisur me leje 59 transportues (autobus, minibus, autotaxi) dhe janë pajisur me licenca 5 operatorë.

Janë ndërtuar 5 mijë e 800 metra shtigje të biçikletave.

Është realizuar projekti i vendosjes së shenjzimit horizontal dhe vertikal.

Gjatë këtij viti Shërbimi i Zjarrfikavë ka intervenuar në 784 raste.

DREJTORIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Këtë vit i kemi përkrahur 10 fermerë me fidane të mjedrës me nga 1100 euro në formën e pagesave direkte.

Në projektin e furnizimit me fidanë të feferonëve kanë përfituar 15 fermerë nga 700 euro në formën e pagesave direkte.

Pastaj 43 fermerë janë përkrahur me dy lloje të pajisje për pemëtari.

143 fermerë janë përkrahur me disa lloje të mekanizmit bujqësor të ndara në dy lote.

10 fermerë janë përkrahur me Laktofrizë 300l dhe 5 fermerë me Mikserë voluminoz për ushqim.

Gjithashtu në muajin nëntor është hapur ftesa publike për 162 mëshqerra dhe komisioni është duke e bërë vlerësimin e kërkesave të fermerëve.

Gjatë këtij viti në sektorin e bletarisë kanë përfituar pajisje 15 fermerë.

Këtë vit në kaudër të projekteve të Drejtorisë është përkrahur edhe sektori i shpeztarisë, ku 3 fermerë kanë përfituar printer automatik për vulosjen e vezëve.

Gjithashtu është hapur thirrja edhe për dhënie të serrave, ku pritet të mbështeten 149 fermerë me serra të madhësive të ndryshme 50 m², 500 m² dhe 1000 m².

Ka përfunduar me sukses thirrja për pagesa direkte, ku këtë vit kanë aplikuar më shumë se 3 mijë fermerë nga Komuna e Podujevës, e të cilët i financon Ministria e Bujqësisë.

Projekte tjera në bashkëpunim me organizata:

Komuna e Podujevës në bashkëpunim me Care International ka implemetuar projektin “Avancimi dhe Përfshirja e Agrobizneseve të Grave në Kosovë (AKWA). Në kuadër të këtij projekti janë përkrahur 35 femra me paisje për bletari, për përpunimin e qumështit, motokultivatorë dhe serra 50m².

DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Njësia e Shërbimeve Komunale deri më tani i ka ndërmarrë këto veprime: 531 inspektime të përbashkëta; 2 raste të largimit të pengesave në rrugë, mure, shtylla, tregje, etj., 4 gjoba mandatore, 40 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

Njësia e Tregut; 244 inspektimi me procesverbal; 1 vendim për asgjësim të ambalazhës në vlerë mbi 41000euro; 12 vendime për plotësimin e Kushteve Minimale Teknike; 10 vendime për Gjoba Mandatore; 976 kontrolla të Përbashkëta; 3 aksione me Policinë; 12 përgjigje ndaj ankesave të konsumatorëve; 1 mbyllje të biznesit, etj.

Njësia e Mbrojtjes së Mjedisit; 165 kontrolle inspektuese të rregullta; 19 gjoba mandatore; 3 kërkesa të Policisë, etj.

Njësia e Komunikacionit; 51 inspektime me procesverbal; 26 vendime për gjoba mandatorë; 2 konfiskime të automjeteve në kohëzgjatje prej 48 orëve; 740 inspektime të përbashkëta; 34 inspektime me Policinë në Podujevë, etj.

Siç e shihni kjo Drejtori ka një varg gjobash mandatorë, por që nëse e marrim si total dhe e analizojmë nuk është që tregon për një efikasitet, çfarë duhet të shquhet një Drejtori e Inspeksionit dhe na mbetet që në mandatin e ardhshëm me punua pak më shumë, më pak të jepen letra dhe më shumë të jepen gjoba dhe me krijua rend dhe rregull.

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Në bashkëfinancim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal jemi duke e ndërtuar Tregun e Gjellbër në vlerë prej 1,455,954.50 €.

Është realizuar projekti “Ngritja dhe Zhvillimi i Bizneseve” – ku janë mbështetur me pajisje pune 53 biznese ekzistuese dhe 61 start up.

Projekti është realizuar me dy thirrje në të cilat kanë përfutur 114 qytetarë dhe janë shpërndarë 251 pajisje. Prej tyre 85 përfutues janë gra dhe 26 janë burra.

Pajisjet e shpërndara janë 16 mikserë për brumë, 21 furra për pjekje, 25 frigoriferë për ëmbëlsira, 11 makina për petë, 14 hekurë për hekurosje, 36 makina për qepje të drejtë, 41 makina për qepje overlluk, 35 makina për qepje Iberdek, 12 makina për shtypje të nxehtë, 10 kompresorë 500l, 5 set komplet i veglave, 17 ngritës për vetura 4000kg dhe 8 aparate saldimi CO2.

Vlera totale e këtij projekti është 264 mijë e 240 euro.

Këtë vit është bërë rrënimi i objekteve të vjetra të ish-kooperativave bujqësore në Dumnicë, Kërpimëh, Bajçinë, Llapashticë dhe Sfeçël, ku pastaj janë krijuar hapësira të gjellbëruara për pushim dhe rekreacion. Vlera e këtij projekti është 99 mijë e 999.70€.

Gjatë këtij viti kjo Drejtori i ka pasur 413 regjistrime të reja të bizneseve, 174 ndryshime në biznes etj.

Këto janë punët dhe angazhimet të përgjithshme të projekteve të realizuara dhe të atyre në proces të realizimit për vitin 2025. Gjithashtu kam edhe të dhënat rreth buxhetit dhe shpenzimit të buxhetit, të gjitha të specifikuara, por për shkak të kohës nuk u ndala në detaje, për të mos ju marr shumë kohë, por nëse do të ketë ndonjë interesim do të jem i gatshëm të ju përgjigjem. Gjithashtu këtu kam edhe procedurat e zhvillimit të projekteve që kapin vlerën diku prej 9, 961173 €, të cilat çdo njëra prej tyre janë të specifikuara me gjatësinë e rrugëve të asfaltuara dhe vlerën e çdo njërit prej projekteve dhe për të gjitha këto jam i gatshëm të jap përgjigjet varësisht prej interesimit tuaj. Faleminderit për vëmendje, fjala është e juaja, nëse dikush ka ndonjë pyetje apo diçka që ju intereson.

z. Abdyl Kastrati, nga fshati Obrançë, theksoi, caktimi i varrezave të Qytetit në fshatin e Obrançës nuk është vendim i ligjshëm për faktin se rrjedha e ujit prej varrezave shkon në drejtim të bunarëve tona të fshatit që i kemi për ujë të pijes. Vullneti jonë si banorë nuk është marrë fare në konsideratë dhe as që është mbajtur dëgjim publik për caktimin e atij lokacioni për varreza të qytetit.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, për opinionin publik por edhe për ju të pranishëm; Më datë 24 mars 2011 është Kuvendi komunal ka miratuar Vendimin për caktimin e lokacionit për varreza të qytetit, ku Kryesues i Kuvendit ka qenë i ndjeri Hazir Raçi dhe jo Shpejtim Bulliqi. Pra lokacioni për varreza është caktuar në vitin 2011, në pronën shoqërore të ish Kooperativës Bujqësore, Zona Kadastrale Obrançë.

Më datë 23.03.2013 është miratuar Vendim në Kuvendin e Komunës së Podujevës për përcaktimin e interesit publik të një pjese të tokave, pronë shoqërore e ish Kooperativës Bujqësore “ Përparimi “ Podujevë, e evidentuar në Certifikatë pronësore Zona kadastrale Obrançë, ndërsa Kryesues i Kuvendit ka qenë i ndjeri Hazir Raçi, pra dy vendime sa i përket varrezave.

Kjo është ecuria e procesit sa i përket varrezave të Qytetit dhe unë nuk kam marrë vendim, por kam zbatuar vendimet e Kuvendit të vitit 2011 dhe 2013.

Sa për njoftim tuajin një vit e gjysmë më kanë thënë se po sigurojnë pronën diku tjetër dhe po bëjmë ndërrim të pronës, dhe si rezultat i kësaj një vit e gjysmë e kam shtyrë projektin mbi një milion euro investim, për shkak të mos seriozitetit të tyre. Vendimet janë në fuqi dhe nuk

shfuqizohen, ne nuk kemi ku ti varrosim të vdekurit, nuk kemi më hapësirë për varreza dhe ne detyrohemi për të bërë zgjidhje. Kemi shpronësuar pronë nga AKP-së dhe e kemi bërë pagesën në emër të shpronësimit për varreza të qytetit të Podujevës, ndërsa këta(banorët e atij lokaliteti) e kanë qëllimin e zgjerimit në atë pronë apo të uzurpimit për nevoja të veta, ndërsa tash thonë po na pengojnë varrezat. Varrezat e fshatit Obrançe i kam para shkolle dhe ato nuk i frikësojnë fëmijët dhe as nuk ua ndotin ujin fshatit. Dihen pretendimet e tyre dhe ne nuk duam të merremi me to. Në këtë aspekt jemi me bazë të plotë ligjore dhe me vendime në fuqi të cilat kemi obligim ligjor ti zbatojmë.

z. Qamil Zeka, përfaqësues i fshatit Metergoc, theksoi, fillimisht z. Kryetar ju uroj postin e mandatit të ri. Kam një kërkesë, ka dy vite e kërkoj një pahi mbrojtës të asfaltit por ende nuk kemi asgjë, aty dy lakesa të metalit urgjente duhet për t'i vendosur, për shkak të sigurisë.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi se do të interesohemi dhe do ta zgjedhim këtë problem.

z. Bedri Bajgora, theksoi, kam një pyetje, a lejohet ndërtimi një objekt pran magjistrales Podujevë-Merdare. Aty kemi pronë tonën familjare dhe jemi të interesuar për ndërtimin e një objekti. Lejën ndërtimore ende Drejtoria përkatëse nuk na ka lëshuar, kështu që desha të pyes se a ekziston mundësia për ndërtim.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, lidhur me ndërtimin duhet patjetër të merret leja e ndërtimit në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM, sepse janë rregullat ligjore në fuqi të cilat kërkojnë distancën distancën prej rrugës magjistrale dhe duhet respektuar ato rregulla, përveç kësaj duhet konsultuar Hartën Zonale se çka planifikohet në atë pjesë. Mirëpo për këtë çështje duhet të drejtoheni në DPUMM sepse aty janë ekspertët, inxhinierët e arkitekturës dhe të ndërtimtarisë të cilët do ti japin informacionet e sakta.

z. Ismail Zhegrova, nga fshati Gllamnik, theksoi, dua te flas për një shqetësim te rruga te shkolla në fshatin Gllamnik, është shumë rrezik për fëmijët të cilët e kalojnë rrugën për te shkolla, sepse aty ka pas edhe aksidente me vdekje. Përveç kësaj është shumë e nevojshme të vendoset edhe ndriçimi, por edhe shenjat e trafikut në atë pjesë të rrugës.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, ky është shqetësim edhe i yni. Çështjen e dritave apo të ndriçimit do ta zgjedhim, por problemi më i madh është për fëmijët apo nxënësit e shkollës. Ne jemi të shqetësuar për situatën e atij nënkalimi aty, i cili është bërë aty. Këtë javë kam informacione se është bërë shpronësimi i pronave nga Ministria e Infrastrukturës dhe tani është më lehtë për të vepruar. Besoj se së shpejti në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës do ta rivitalizojmë nënkalimin për nevoja të fëmijëve në mënyrë që mos të rrezikohen fëmijët në atë pjesë sepse kemi pas edhe dy aksidente me fatalitet aty, kështu që jemi të vetëdijshëm për këto dhe do të bëjmë çmos që atë nënkalim ta bëjmë aktiv. Sikurse jeni një dijeni një familjar aty pranë e shkollës e ka penguar dhe nuk ka lejuar punimet në atë pjesë, ndërsa në anën tjetër e kemi krye në tërësi, dhe vetëm pjesa dalëse është penguar prej një qytetari në emër të shpronësimit dhe besoj se do të zgjidhet ky problem.

Megjithatë sa për njoftim rruga magjistrale Podujevë-Prishtinë nuk është në kompetencë të Komunës, pra nuk e menaxhojmë ne si Komunë por e menaxhon Ministria e Infrastrukturës por ne kemi kontakte të rregullta me ta dhe do të bëjmë çka është e mundur për të zgjidhur këtë problem. Nëse nuk ka pyetje tjera unë e përmbyll takimin duke i falënderuar të gjithë për pjesëmarrje dhe kontributin.

Po ashtu ju uroj të gjithëve Vitin e Ri 2026 me shëndet për të gjithë ju dhe në familjet e tua.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20

Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani

Nr.Prot.02-016/01-0082436/25
Podujevë, datë:26.12.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi